



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE-MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE-MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY	
Njësia Org. Org.Jedinita Org.Unit	02/11/12
Nr. Prot. Broj Prot. Prot.No.	1758
Nr. faqeve Broj stranic No. pages	2
Data. Datum Date	30.04.12
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine I Industrije-Ministry of Trade and Industry

Inspektorati I Tregut /Tzisna Inspekcija/Trade Inspection

Nr.Ref. 02/2012
Prishtinë:30/04/2012

Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut , duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 18.1 pika (f) , paragrafi 18.5 i Ligjit Nr.2004/17 “Per Mbrojtjen e Konsumatoreve “, nenit 2 të Udhezimit Administrativ Nr.2009/21 “Per Plotesimin dhe ndryshimin e Udhezimit Administrativ Nr.2007/05 “Per Etiken dhe Deklarimin e Mallit “, me datë 27 Prill 2012 , mori këtë :

VENDIM

- I. Ndalohet Importi i produkteve dhe vendosja e tyre në tregun e brendshëm të Republikës së Kosovës me mbishkrimin UNMIK/KOSOVO;
- II. Ndalimi i importit dhe vendosja e produkteve në tregun e brendshëm sipas paragrafit 1 të këtij Vendimi , do të fillojë të zbatohet nga data 1 Maj 2012 .

Arsyetim

Inspektorati i Tregut , gjatë monitorimit të tregut të brendshëm ka hasur në produkte të cilat në etiketën dhe deklaracionin e mallrave , akoma e kanë të vendosur mbishkrimin UNMIK /KOSOVO .

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë respektivisht Inspektorati i Tregut , i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nenligjore në fushën e tregtisë dhe mbrojtjes së konsumatorit , konsideron se veprimet e tilla janë në


kundershtim me Ligjin per Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Udhezimin Administrativ per etiketen dhe deklarimin e mallit , ne te cilat dispozita eshte percaktuar qe etiketa dhe deklarimi i mallit duhet te permbaje emrin e plote dhe te sakte te importuesit apo/ose distributorit si dhe emrin e vendit te tyre.

Prandaj siq dihet ,qe nga shpallja e Republikes se Kosoves me date 17 Shkurt 2008 ,si dhe qe nga hyrja ne fuqi e Kushtetutes se Republikes se Kosoves me date 09 Prill 2008 , emri i plote dhe i sakte i vendit tone eshte Republika e Kosoves .

Duke marr parasysh ate qe u cek me larte , vijme ne konkluzion se te dhenat e vendosura ne produkte me mbishkrimin e Misionit te Administrates se Perkohshme te Kombeve te Bashkuara ne Kosove (UNMIK) , jane ne kundershtim se pari me aktin me te larte juridik te vendit ,duke vazhduar me shkeljen e dispozitave te ligjeve dhe akteve nenligjore ne fuqi , prandaj u vendos si te dispozitiv te ketij Vendimi.

Vendimi I dërgohet:

- Doganës se Kosovës ;
- Odes Ekonomike te Kosovës ;
- Aleancës Kosovare te Biznesit ;
- Odes Ekonomike Amerikane;
- Arkivit te MTI-se.

Ruzhdi SHEHU

Kryeinspektor i Inspektoratit te Tregut